REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.4289/1 prot. Lushnje më, 20/05/2024

PROJEKT VENDIM

Nr.57, Datë 20/05/2024

"PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT DHE FONDIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E VARREZAVE TE DËSHMORËVE"

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës ____/____/ 2024, bazuar në relacion e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Për miratimin e projektit dhe fondit për Rikonstruksionin e Varrezave të Dëshmorëve ,Lushnje" si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Per vetëqeverisjen vendore"*, neni 9 pika 1.1,gërma "a",neni 14 pika 3,neni 22,23 pika 7,neni 36.VKM-së nr 786 date 11.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për ndërtimin,mirëmbajtjen dhe ruajtjen e Varrezave të Dëshmoreve të Atdheut",neni 6,Ligji nr 80/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", neni 3/c ; Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, nenet 6,15,40 dhe neni 44 germa "a", Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit|"pikat 109,120,130;

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë projektin për Rikonstruksionin e Varrezave të Dëshmorëve Lushnje si investim me bashkëfinancim midis Bashkise Lushnje dhe Qarkut Fier
2. Fondi i parashikuar prej 4,982,920 lekë të shkoj për për mbulimin e kostos së bashkëfinancimit për projektin "Rikonstruksioni i Varrezave të Dëshmorëve, Lushnje".
3. Ky fond ti kalojnë Këshillit të Qarkut Fier,me destinacion projektin e mësipërm si institucioni që do të zbatoje projektin .
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria Juridike.
5. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

DREJTORIA E FINANCË DHE BUXHETIT
Juljana Hasalla

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com